REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

# VENDIM

Nr. 985, datë 9.12.2015

MINIS...
Nr. 7166
Datë 11.12.15

## PËR

## NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1 dhe 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës "C", "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", regjistrohet individi i renditur në shkronjën "a", të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatës Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME

DITMIR BUSHATI

## AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT ("LISTA E OKB-së")

### C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

**a)** Lista e shtuar në **"Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida";**

1. EMRAH; ERDOGAN.

Shënim: Gjeneralitetet e tjera për personin emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahet në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

NR.PROT.5831/1
DATË 10.12. 2015

MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTRISË SË DREJTËSISË
SHISH
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
BANKËS SË SHQIPËRISË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE